



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:000309
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05763552

C.nr.1548/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridike të paditësit H (Sh) M nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. G.Sh, kundër të paditurve N (M) E, A (B) E, J (B) E, D (B) E, D1 (B) E, M (B) E, M1 (M) E, H (M) E, R (H) E, A (H) E, S (H) E që të gjithë nga Rahoveci, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson N (M) E nga Rahoveci, lidhur me vërtetimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seance, me datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit H (Sh) M nga Rahoveci, e ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër të paditurve N (M) E, A (B) E, J (B) E, D (B) E, D1 (B) E, M (B) E, M1 (M) E, H (M) E, R (H) E, A (H) E, S (H) E që të gjithë nga Rahoveci, lidhur me vërtetimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues.

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi H (Sh) M nga Rahoveci përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, Av. G.Sh, ka ushtruar padinë, kundër të paditurve N (M) E, A (B) E, J (B) E, D (B) E, D1 (B) E, M (B) E, M1 (M) E, H (M) E, R (H) E, A (H) E, S (H) E që të gjithë nga Rahoveci lidhur me vërtetimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, av. G.Sh, me parashtresë të veçantë me datë 29.05.2024 e ka tërhequr padinë.

Andaj kjo gjykatë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditësit është tërhequr.

Numri i lëndës: 2024:000309
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05763552

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1548/2023, më datë 31.05.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.